
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: PRO MEDICAL SH.P.K., Rr. Kadri Zeka, 70000, Ferizaj Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	22.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **19.04.2024**, në Ora: **19:54 h**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SERVISIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-1132-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-017-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SERVISIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-1132-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-017-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **19.04.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-1132-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-017-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SERVISIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-1132-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-017-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **19.04.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **19.04.2024**, në Ora: **19:54 h**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Përgjigje për pretendimet e tua ankimore:

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit *B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar*, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2: Dy (2) Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2: Certifikata trajnimi për Serviser të Certifikuar dhe te bashkangjitura me kontrata te punës;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike, keni prezantuar z. Adnan Bala dhe z. Nazim Lohaj;

Certifikata e dorëzuar për z. Adnan Bala, nuk është e drejtimit përkatës sipas Kërkesës në Dosjen e Tenderit:



Detect language Albanian English Spanish ▾

↔ Albanian Serbian English ▾

has completed the online course and he is certified and training for equipment maintenance, services and repair of vitro diagnostic device (IVD).
E-LAB Biological Science & Technology Co., LTD
Nanjing, China
From Sep. 17th to 20th 2021

ka përfunduar kursin online dhe është i certifikuar dhe trajnime për mirëmbajtjen e pajisjeve, shërbimet dhe riparimin e pajisje diagnostike vitro (IVD).
E-LAB Shkenca Biologjike & Technology Co., LTD
Nanjing, Kinë
Nga data 17 deri më 20 shtator 2021

234 / 5,000

Send feedback

Po ashtu Kontrata e dorëzuar për Adnan Bala, në Nenin 1 të kësaj Kontrate Ceket, shih foto:

Faqe 1 prej 4

Në bazë të nenit 10, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2 dhe nenit 11 të ligjit të punës 03/L-212, i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies Juridike të punës, lidhin:

PRO MEDICAL

KONTRATË PUNE PËR KOHË TË PA CAKTUAR

Neni 1

Me këtë kontratë, "PRO MEDICAL" SH.P.K me seli: Rr. Kadri Zeka, Ferizaj, me NRF: 811394212 dhe NRB: 811394212 që e përfaqëson Adnan Bala (në tekstin në vijim: Punëdhënësi), lidh kontratë pune me Adnan Bala, me numër personal 2018291137, me banim në , Ferizaj, që posedon kualifikimin Mesem, në tekstin në vijim i Punësuari.

Ndërsa në kundërshtim me Nenin 1 të kësaj Kontrata, Nënshkrimi i Kontratës për Punëdhënësin është bërë nga Nexhmije Bala, shih foto:

Nënshkruar më 01.02.2024

PALËT KONTRAKTUESE:

I PUNËSUARI

Adnan Bala



PUNËDHËNËSI

Nexhmije Bala

Ne si AK: Komuna e Rahovecit, në bazë të formularit: B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, kemi kërkuar këto sqarime, duke cekur:

Pra në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, përkatësisht të nenit 72 kërkoj sqarime shtesë si në vijime:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2: Dy (2) Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike;

Dëshmia 2: Certifikata trajnimi për Serviser të Certifikuar dhe të bashkangjitura me kontrata të punës;

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën, Serviser të Certifikuar për Adnan Bala, Kontrata e punës e prezantuar, tek Pjesa për Punëdhënësin, kontrata është e Nënshkruar nga Nexhmije Bala, e cila nuk është bashkëpronarë në Certifikatën e Biznesit, po ashtu nuk ka ndonjë autorizim për nënshkrimin e kontratës;

Ne si Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni **Autorizim të Kompanisë nga Noteri për Nexhmije Bala, që ka Autorizim për Nënshkrimin e Kontratës, duke u bazuar në nenin 72**

Ju si Operator Ekonomik, nuk keni arriture të dorëzoni Autorizim të Kompanisë nga Noteri për Nexhmije Bala, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit